

VENDIM
Nr. 497, datë 10.9.2025

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 549, DATË 4.9.2024,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E MJETEVE AJRORE PA
PILOT NË ADMINISTRIM TË FORCAVE TË ARMATOSURA NË MBËSHTETJE TË
INSTITUCIONEVE SHTETËRORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 7978, datë 26.7.1995, “Për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të pikës 5, të nenit 24, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 549, datë 4.9.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e mjeteve ajrore pa pilot në administrim të Forcave të Armatosura në mbështetje të institucioneve shtetërore”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në kreun I, pas fjalës “... shtetërore ...” shtohen fjalët “... ose subjekte tregtare me kapital shtetëror ...”.

2. Në pikën 1, të kreut II, pas fjalëve “... një apo më shumë institucione ...” shtohen “... ose subjekte tregtare me kapital shtetëror ...”.

3. Në kreun III bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Në pikën 1 bëhen këto shtesa:

i. Pas shkronjës “ë” shtohet shkronja “f”, me këtë përmbajtje:

“f) ministria përgjegjëse për financat dhe institucionet në varësi;”.

ii. Pas shkronjës “f” shtohet shkronja “g”, me këtë përmbajtje:

“g) ministria përgjegjëse për shëndetësinë dhe institucionet në varësi;”.

b) Pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1. Subjektet tregtare me kapital shtetëror, në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në legjislacionin e tyre të posaçëm, kërkojnë dhe marrin shërbimin e mjeteve ajrore pa pilot të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Marrja e këtij shërbimi ofrohet kundrejt tarifës, e cila përcaktohet me urdhër të përbashkët të ministrit të Mbrojtjes dhe ministrit të Financave.”.

c) Në pikën 9, fjalët “Institucionet shtetërore, të përcaktuara në pikën 1...” zëvendësohen me “Subjektet e përcaktuara në pikat 1 dhe 1/1 ...”.

ç) Në pikën 10, fjalët “... institucioneve shtetërore, të përcaktuara në pikën 1 ...” zëvendësohen me “... subjekteve të përcaktuara në pikat 1 dhe 1/1 ...”.

d) Në pikën 12, fjalët “... institucioneve të përcaktuara në pikën 1 ...” zëvendësohen me “... subjekteve të përcaktuara në pikat 1 dhe 1/1 ...”.

4. Në kreun IV bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikën 1 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

i. Në pjesën hyrëse, fjalët “... institucioneve shtetërore sipas pikës 1 ...” zëvendësohen me “... subjekteve sipas pikave 1 dhe 1/1 ...”.

ii. Pas shkronjës “l” shtohen shkronjat “ll” dhe “m”, me këtë përmbajtje:

“ll) mbikëqyrjen, monitorimin dhe kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së *cannabis-it* dhe të prodhimit të nënprodukteve, produkteve të saj për qëllime mjekësore e industriale, sipas legjislacionit në fuqi.

m) mbikëqyrjen dhe monitorimin e transportit e të lëvizjes së mallrave që ndjekin një regjim të caktuar doganor.”.

b) Në pikën 3, fjalët “... institucionet e përcaktuara në pikën 1 ...” zëvendësohen me “... subjektet e përcaktuara në pikat 1 dhe 1/1 ...”.

5. Në kreun V bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në pikën 1, fjalët “Institucionet shtetërore të ...” zëvendësohen me “Subjektet e ...”.

b) Në pikën 5, fjalët “Institucionet shtetërore ...” zëvendësohen me “Subjektet e përcaktuara në kreun III ...”.

II. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura dhe institucionet shtetërore të përmendura në kreun III për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama